



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

SHPALLJEN E REKRUTIMIT

Inspektorati i Energjisë

Numri i Konkursit: APF0004925

Vendi i punës: Inspektor për Energji Termike - INS/270

Koeficienti : 8.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i Inspektoratit të Energjisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen inspektimin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve ligjore në lëmine e energjisë termike;
- Urdhëron heqjen e parregullsive të vërejtura dhe caktimin e afatit për eliminimin e tyre;
- Ka autorizim të ndaloj ndërtimin e objektit në qoftë se nuk është marrë leja për ndërtim;
- Të urdhëroj pezullimin e ndërtimit të mëtejshëm, gjegjësisht ndërprerjen e furnizimit me energji termike, apo shfrytëzimin e energjisë termike, nëse këto objekte nuk janë ndërtuar, nuk përdoren ose nuk mbahen në përputhje me dokumentet e miratuara ose certifikuara më rregulloret e veçanta teknike ose të tjera dhe për shkak të këtyre paraqitet një kërcënim i menjëhershëm për stabilitetin dhe sigurinë e objekteve energjetike, shëndetin apo jetën dhe sigurinë e trafikut ose ndërtesave ngjitur më këto objekte;
- Mbikëqyrë ndërtimin, projektimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për prodhimin e energjisë termike duke ofruar këshilla profesionale;

- Merr pjesë në adoptimin dhe përshtatjen e standardeve relevante vendore me ato ndërkombëtare në lëmin e energjisë termike;
- Harton planin e punës dhe sipas nevojës kryen punë të tjera administrative;
- Me të dhënat e mbledhura nga terreni formon bazën e shënimeve të pajisjeve për prodhimin e energjisë termike;

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë Universiteti në lëmin përkatëse – Inxhinier i diplomuar i Makinerisë.
- Përvoja e punës së paku 3 vite në profesion .
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur;
- Njohuria me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së në lëmin e shkencave teknike, ambientit dhe sigurisë në punë;
- Aftësi për punë me kompjuter OS MS Windows, MS Office (Word, Excel, PowerPoint, Outlook);
- Aftësia të punon në nivelim më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës;

Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës

- Puna në teren gjatë vizitave inspektuese
- Rreziqet me rastin e pjesëmarrjes në shqyrtimin e kaldajave dhe tubacioneve për shkak të shfryrjeve që mund të shkaktohen.
- Rreziqet që mund të shkaktohen nga lartësia, nxehtësia dhe pluhuri me rastin e inspektimit të kaldajave të gjenerimit të energjisë ngrohëse.
- Rrezikshmëria për jetë është sidomos me rastin e inspektimit të brendshëm të kaldajave

Numri i Konkursit: APF0004926

Vendi i punës: Inspektor për Energji Elektrike - INS/260

Koeficienti : 8.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i Inspektoratit te Energjisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen inspektimet e pajisjeve elektro-energjetike në teren në mënyrë profesionale dhe të pavarur dhe bënë vlerësime në situata komplekse siç janë incidentet dhe aksidentet;
- Harton raportet e mbikëqyrjes inspektuese nga terreni duke dhënë rekomandime dhe vërejtje për eliminimin e mangësive ;
- Propozon për masat ligjore administrative sipas nevojës;
- Merr pjesë në shqyrtimet e pajisjeve dhe stabilimenteve elektro-energjetike duke kontribuar me njohuri të tij profesionale;
- Mbikëqyrë ndërtimin, projektimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektro-energjetike duke ofruar këshilla profesionale;
- Merr pjesë në adoptimin dhe përshtatjen e standardeve relevante vendore me ato ndërkombëtare në lëmin e energjisë elektrike;
- Harton planin e punës për sektorin e energjisë elektrike dhe sipas nevojës kryen punë të tjera administrative ;

- Me të dhënat e mbledhura nga tereni formon bazën e shënimeve të pajisjeve energjetike;

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë Universiteti - Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës-dega energjetika.
- Përvoja së paku 3 vjet .
- Aftësi komunikuese dhe organizative, si ndërtimi dhe përkrahja e punës në ekipe, motivimi dhe promovimi i metodave bashkëkohore të punës;
- Aftësi për të ndërmarr iniciativa dhe të punoj në mënyrë të pavarur;
- Njohuria me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së në lëmin e shkencave teknike, ambientit dhe sigurisë në punë;
- Aftësi për punë me kompjuter OS MS Windows, MS Office (Word, Excel, PowerPoint, Outlook);
- Aftësia të punon në nivelim më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës

Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës

- Puna në teren gjatë vizitave inspektuese
- Rreziqet me rastin e pjesëmarrje në shqyrtimit të pajisjeve elektro-energjetike nga tensioni i energjisë elektrike.
- Rrezikshmëria për jetë është sidomos me rastin e inspektimit të brendshëm të trafo stacioneve të tensionit 400 KV; 220 KV; 110 KV etj.
- Rreziqet me rastin e inspektimit të avarive në stabilimentet elektron-energjetike

Procedura e konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net> .

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Ministria e Zhvillimit Ekonomik , ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

Afati i konkurrimit është prej datës 21 /03/2019 deri me date 04/04/ 2019, deri në orën 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524